



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



INSTITUTI I KULTURES  
ROME NE SHQIPERI.



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI

Nr. 03 Prot, datë 18. 04.2013

Nr. 285 Prot, datë 18. 04.2013

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**KOMISIONERIT PER MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**DHE**

**INSTITUTIT TË KULTURËS ROME NË SHQIPËRI**

**Për pranimin e studentëve Rom dhe Egjiptian për të kryer praktikën e punësimit pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.**

Me qëllim përmbushjen e të drejtës për përfshirjen sociale dhe integrimin e të rinjve Rom dhe Egjiptian në tregun e punës dhe kryesisht në administratën publike.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri bien dakord si më poshtë:

Mbi bashkëveprimin ndërmjet dy palëve

## **Pika 1. Palët në marrëveshje**

Palët në marrëveshje janë: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Instituti i Kulturës Romë në Shqipëri.

Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri është një organizatë rinore Rome jo-fitimprurese rregjistruar me vendim gjykate nr. 3116 dt. 01.07.2011. Që prej krijimit të tij, Instituti ka kryer një sërë aktiviteteve advokuese, ndërkulturore dhe integruese për të rinjtë rom në rrethe të ndryshme të vendit, si dhe ka qenë pjesëmarrës në grupet teknike të punës për çështjet rome të cilat funksionojnë pranë Këshillave të Qarqeve.

## **Pika 2. Qëllimi i marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi të palëve për bashkëpunimin midis tyre me qëllim aftësimin e të rinjëve rom dhe egjiptian me vendin e punës pranë administratës shtetërore.

Ky bashkëpunim vendoset bazuar në sere dokumentash kombetare dhe nderkombetare si Strategjia për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom; Plani i Veprimit të Dekadës Rome, Strategjia e Punësimit Rinor (2010-2015), si edhe një numër urdherash dhe akte normative të Këshillit të Ministrave për punësimin e minoriteteve etj. Po ashtu ky bashkëpunim i shërben edhe realizimit të pikës 11 të dymbëdhjetë prioritetëve kryesorë të vendosura nga Bashkimi Europian për Qeverinë Shqiptare për hapjen e negociatave për anëtarësim të Shqipërisë në BE dhe është në linjë të plotë me thirrjen që BE u ka bërë vendeve anëtarë që brenda vitit 2020 të miratojnë plane veprimi për përfshirjen sociale të minoritetit Rom.

Vendosja e urave të bashkëpunimit për të pranuar studentë rom dhe egjiptian për të kryer praktika punësimi, për vitin 2013 realizohet në kuadrin e iniciativës “RomVERITAS” – Mbështetje Arsimore, Këshillim Kariere dhe Aftësim për Pjesëmarrje në Proceset Vendimarrëse për të Rinjtë Rom”, që zbatohet nga “Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri” dhe që mbështetet nga Programi “Fuqizimi i Komuniteteve Lokale Vulnerabël në Shqipëri” i UNDP-së. Iniciativa RomVERITAS ndër të tjera synon të nxisë punësimin e të rinjëve Rom dhe Egjiptian të arsimuar në administratën shtetërore nëpërmjet kryerjes së praktikës në vendin e punës.

Për vitet e ardhshme lehtësimi i praktikave të punës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të bazohet në programet e nxitjes së punësimit të zbatuara nga MPCSSHB dhe kur është e mundur edhe në programet përkatëse të organizatave ndërkombëtare dhe partnere. Në pamundësi të sigurimit të mbështetjes nga programet e nxitjes së punësimit, praktika e punës do të bazohen mbi programet e vullnetarizmit dhe legjislacionit përkatës që rregullon këtë veprimtari.

### **Pika 3. Kohëzgjatja**

Marrëveshja e bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri do të vazhdojë për sa kohë që punësimi i të rinjve rom është proritë e Qeverisë Shqiptare, bazuar në Planin e Dekadës së Përfshirjes së Romëve (2010-2015) si dhe kërkesave të Bashkimit Europian për hartimin dhe zbatimin efektiv të planeve kombëtare deri në vitin 2020;

### **Pika 4. Përgjegjësitë e palëve**

Në përputhje me pikën 1, palët në marrëveshje bien dakord si më poshtë:

A. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi angazhohet të:

- a. Të Konsiderojë iniciativën RomVERITAS si një program bashkëpunues, ndihmues për Mbështetjen Arsimore, Këshillim Kariere dhe Aftësim për Pjesëmarrje në Proceset Vendimarrëse dhe Tregun e Punës për të Rinjtë Rom” në Shqipëri;
- b. Të pranojë rregullisht në përputhje me nevojat e institucionit, studentë dhe të diplomuar që i përkasin komunitetit Rom, të referur nga IRCA, me qëllim për të zhvilluar praktikë pune me kohezgjatë nga një deri në tre muaj sipas rastit;
- c. Të konsiderojë me prioritet punësimin e të rinjve rom të arsimuar, pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe të promovojë punësimin e tyre në institucione të administratës publike në nivel qendror dhe lokal;
- d. Të mbështesë përpjekjet e Institutit të Kulturës Rome për të bërë të zbatueshme programet e nxitjes së punësimit të MPCSSHB për të rinjtë rom të interesuar për të ndjekur praktikë pune pranë institucioneve të administratës publike;

B. Instituti i Kulturës Romë në Shqipëri (IRCA) angazhohet të:

- a) Të koordinojë identifikimin dhe referimin pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të studentëve dhe të diplomuarve rom të interesuar për të kryer praktika pune vullnetare dhe kur është e mundur me mbështjen e programeve të nxitjes së punësimit të MPCSSHB, organizatave ndërkombëtare e organizatave të tjera partnere;
- b) Të orientojë praktikantët rom që kryejnë praktikë pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rreth politikave të përfshirjes sociale të minoritetit rom si dhe të asistojë ata në përmbushjen me sukses të periudhës së praktikës;
- c) Të bashkëpunojë me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për probleme konkrete të vërejtura ose të referuara në lidhje me aksesin në arsim dhe tregun e punës të të rinjve rom;

#### **Pika 5. Mbështetja financiare**

Bashkëpunimi në fjalë i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri do të bazohet kryesisht në programet e nxitjes së punësimit të Ministrisë së Punës Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe ndihmës që organizata ndërkombëtare dhe partnere mund të ofrojnë për të mbuluar shpenzimet bazë të praktikantëve gjatë periudhës së praktikës. Në pamundësi të sigurimit të ndihmës financiare për mbulimin e shpenzimeve përkatëse, praktika do të jetë një angazhim vullnetar i të rinjve në përputhje me rregullat dhe procedurat e angazhimit vullnetar në vend.

Siç është theksuar më lart, ky bashkëpunim është pjesë e arritjes së qëllimit të ofrimit të aksesit të barabartë në kualifikime dhe në tregun e punës për të rinjtë rom, në përputhje me politikat qeveritare të nxitjes së punësimit dhe vullnetarizmit;

#### **Pika 8. Modifikime**

Në qoftëse, gjatë kohës së bashkëpunimit del i nevojshëm modifikimi i kësaj marrëveshje ose krijimi i anekseve të veçanta, kjo do të bëhet në bashkëpunim dhe e aprovuar nga të dyja palët me shkrim dhe i bashkëngjitet kësaj marrëveshje.

\* \* \*

Kjo marrëveshje bashkepunimi është përgatitur ne 4 (katër) kopje ( dy kopje për secilën palë, Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri)

Nënshkruar në Tiranë, më 10 / 04 / 2013.

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI**



**Irma BARAKU**

**Për Institutin e Kulturës Rome në**

**Shqipëri**

BLEDAR TAHO

**Bledar TAHO**

